

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët/ Në Gjermani numri arrin rekordin e 124 mijë lejeve
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/be-ka-dhene-11-milione-leje-qendrimi-per-shqiptaret-ne-gjermani-numri-i474060
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 05:15:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 05:03:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d438406085114ac5460f776eef0f5abb17e53c7eb124676de83d9069103c6bb6
TEKSTI	261326bf151b5aef202b9c417918114ecc58585f4d528a0365fd7e3af7cf0f85
PAMJA	df36e48d1cddfe129f38aa36b1d91d2fb8e958e038d4b82f89926e36c13121b7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5e79f6640aaf251de59394b80d32f861938682e845a0768cf0bd6c27bdf1b4d
E MËPARSHMJA	0150c1dfbade8d5dc7073cf90daac0dc0857d85ddb1701c3586e6a1ff2e151a4
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5e79f6640aaf251de59394b80d32f861938682e845a0768cf0bd6c27bdf1b4d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

11:01 Aktualitet

Shtyhet seanca gjyqësore në Gjykatën e Posaçme për dosjen ...

BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët/ Në Gjermani numri arrin rekordin e 124 mijë lejeve



14 Shtator 2026, 07:03, Aktualitet CNA



Emigracioni i shqiptarëve drejt Bashkimit Europian ka mbetur sërish me ritme të larta në 10 vitet e fundit, dhe gradualisht po tejkalon valët e forta të largimeve të dy tre dekadave më parë, kur vendi ishte në një gjendje shumë më të keqe ekonomike, pas kalimit nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut në fillim të viteve '90-2000.

Në 18 vjet, nga 2008-a deri në 2025-n, vendet e BE-së kanë dhënë rreth 1.1 milionë (1,082,224) leje qëndrimi për herë të parë për shtetasit shqiptarë, sipas të dhënave të Eurostat të përpunuara nga "Monitor".

Për periudhën 2008-2016, u dhanë gjithsej rreth 509.5 mijë leje qëndrimi. Shifra e lartë është e lidhur me periudhën 2008-2010, me rreth 70-100 mijë leje në vit, kur ata që ikën në dekadën e mëparshme filluan të stabilizoheshin dhe të mermin leje qëndrimi, kryesisht në Itali dhe Greqi. Të dy këto shtete së bashku dhanë gati 90% të lejeve për periudhën (37% Greqia dhe 53% Italia).

Ndërsa u duk se emigracioni po stabilizohej pas vitit 2012, me numrin e lejeve që u përgjysmuan, një valë tjetër nisi pas 2016-s, që u përshpejtua në dekadën e fundit.

Për periudhën 2017-2025 u dhanë edhe 573 mijë leje të tjera, duke ia kaluar dekadës së mëparshme. Shifrat tregojnë qartë se shqiptarët po vijnë në mënyrë të rritur me ritme më të larta, sidomos nëse e llogarisim në raport me popullsinë, që sot është ulur në 2.3 milionë banorë, nga 3 milionë banorë në 2006-n. (shiko grafikun).

Ndryshe nga dekada e mëparshme, kur Italia dhe Greqia ishin pritësit kryesorë të emigrantëve shqiptarë, gjeografia është zgjeruar vitet e fundit. Për periudhën 2017-2025, Italia dhe Greqia kanë dhënë së bashku 62% të lejeve totale (41% Italia dhe 21% Greqia).

Në skenë vitet e fundit ka dalë Gjermania, që po tërheq forcën punëtore të kualifikuar dhe ka dhënë 20% të lejeve për periudhën 2017-2025. Në total, që nga viti 2008, Gjermania ka dhënë 124 mijë leje qëndrimi për shtetasit shqiptarë, duke u renditur e treta. Kryesimin vijon të mbajë Italia, me 500 mijë leje nga 2008-a, e ndjekur nga Greqia me 311 mijë.

Franca, ndonëse është destinacioni kryesor për azilantët jep shumë pak leje qëndrimi. Nga 2008-a, leje qëndrimi në Francë kanë marrë rreth 28 mijë persona, të ndjekur nga Belgjika me 14.3 mijë dhe Suedia 13 mijë. Shtetet e tjera kanë dhënë nga më pak se 10 mijë leje.


Rreth 20 mijë leje janë dhënë nga Mbretëria e Bashkuar për periudhën 2008-2018, ndërsa më pas të dhënat nuk raportohen. Gjatë dekadës së fundit Mbretëria e Bashkuara ka qenë destinacion i preferuar për shqiptarët, me kërkesat për azil që në 2022-n arritën në mbi 14 mijë, duke ia kaluar totalit të kërkesave në Be prej 13.2 mijë në atë vit.

Viti 2025, Gjermania kalon e dyta për lejet e qëndrimit

Sipas Eurostat, në vitin 2025 u dhanë 68,653 leje qëndrimi për herë të parë për shtetasit shqiptarë, me një rritje prej 4% në krahasim me vitin e mëparshëm. Tendenda është e kundërt me 2024-n, kur lejet ranë me 14%.

Në 2025-n, Gjermania ishte e dyta në total për lejet e qëndrimit, me 17 mijë të tilla, përkundërt 31.7 mijë Italia dhe 10 mijë Greqia. Pas tyre u rendit Franca me vetëm 2.4 mijë leje dhe Belgjika 1.3 mijë. Shtetet e tjera kanë dhënë më pak se 1000 leje.

Në 2025-m, sipas Eurostat, 46.3% e lejeve u dhanë për arsye familjare, 0.8% për edukim, 29.4% për punësim./Monitor.al





Të sugjeruara

"Gjuhë intimiduese ndaj një gjyqtari"/ Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve del me deklaratë

Plarent Ndreca dhe revolucion i madh i Abetares

“Puçi kushtetues i Kushtetueses”/ Gazetari: Puna e pagave të gjyqtarëve është palaçollëk

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët përsërisin thirrjet kundër qeverisë

Reforma në Drejtësi "dështoi" kur u shkoi te dera 'Ndregrave'

“Bujqësia ka humbur mbi 300 milionë euro ndihma”/ Meta: Ky është shqetësimi i shqiptarëve, jo pagat e gjyqtarëve

Goli 8.6 milionë dollarë i Ron Yeffet edhe me këmbën e narkogjatësisë?

Si po përdoret IA-ja për sigurinë në shkollat e Shqipërisë

E diela para Lartësimit të Kryqit/ Kryepiskopi Joan: Sprovat e jetës duhen parë si mundësi shërimi

Përplasja për pagat e magjistratëve/ Rama: Të gjithë të respektojnë Kushtetutën

Shuhen vatrat e zjarrit në të gjithë vendin

Gjergj Luca, sipërmarrësi që ngre qytete/ Fish City Apollonia, një ëndërr e bërë realitet

"Një situatë e tillë nuk është parë në botë"/ Pacolli: Aeroporti i Vlorës nuk duhet të mbetet peng i interesave të askujt

VIDEO/ Rrethohet Kryeministria, protestuesit zhvendosen në hyrjen e pasme të godinës

Zjarret dhe përmbytjet në vend/ Ministria e Mbrojtjes përditësimet për situatën

Deputeti i PD-së nën hetim nga SPAK/ Këllici: Interesi i Ramës kërkon përndjekje të opozitës

FOTOLAJM/ Pankartat në protestën e 105-të kundër qeverisë, mesazhet e diasporës

Kërkohet dorëheqja e Ramës/ Nis protesta e 105 kundër qeverisë

Përplasjet për çështjen e pagave/ Gjyqtari Pëllumbi: SPAK mund të hetojë çdo person ndaj të cilit ka dyshime


105 ditë protestë kundër qeverisë/ Diaspora zbarkon në Tiranë

[editorial](#)

09:41 Editorial

Drejësia shqiptare dhe katër të vërtetat që askush s'i thotë bashkë

CNA LIVESTREAM



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.